

VENDIM
Nr. 391, datë 6.5.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
RRUGËS LIDHËSE MIDIS RRUGËVE “QEMAL STAFI” DHE “ESAT BORDI”, SI DHE
NDËRTIMI I LULISHTES NË PJESËN JUGORE TË BULEVARDIT “AQIF PASHA”, TE
“XHAMLLIKU PARA SAHATIT”, NË BASHKINË E ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës lidhëse midis rrugëve “Qemal Stafa” dhe “Esat Bordi”, si dhe ndërtimi i lulishtes në pjesën jugore të bulevardit “Aqif Pasha”, te “Xhamlliku para Sahatit”, në Bashkinë e Elbasanit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Elbasanit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqet 639.43 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë dyzet e tre) m² “truall” dhe 410.77 (katërqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e shtatë) m² “njësi”, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 35 491 002.68 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e dy pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 35 491 002.68 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e dy pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Elbasanit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Elbasanit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Elbasanit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurive prej 639.43 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë dyzet e tre) m² “truall” dhe 410.77 (katërqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e shtatë) m² “njësi”, për ndërtimin e rrugës lidhëse midis rrugëve “Qemal Stafa” dhe “Esat Bordi”, si dhe ndërtimin e lulishtes në pjesën jugore të bulevardit “Aqif Pasha”, te “Xhamlliku para Sahatit”, të bëhet në favor të Bashkisë së Elbasanit.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LULISHTES NË PJESËN JUGORE TË BULEVARDIT “AQIF PASHA”

			Vërtetim pronësie			Truall			Njësi				Shpronësi mi	
N r.	Familja	Nr. i	m ²			shpronësi m	çmimi	shpronësim	sip. e njësisë në m ²		çmimi	shpronësim	Shuma	Lloji i dokumentit të pronësisë
	që shpronësohet	pasurisë	truall	banesë	njësi	m ²	lekë/m ²	lekë	preket	shprons	Lekë/m ²	lekë	lekë	
1	Selman R.Belshaku,Valb ona D.Belshaku	1/14- N.3	24.39	0.00	26.81	24.39	9460	230729.40	26.81	26.81	66140	1773213.40	2003942.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Kadri Qerim Krasniqi	1/14- N.2	0.00	0.00	23.00	0.00	9460	0.00	23.00	23.00	66140	1521220.00	1521220.00	Barrë hipotek. sekuestro
3	Sherife Doksani	1/14- N.11	0.00	0.00	43.50	0.00	9460	0.00	43.50	43.50	66140	2877090.00	2877090.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Sanije Tirana, Nadire Idrizi	1/14- N.10	0.00	0.00	55.00	0.00	9460	0.00	55.00	55.00	66140	3637700.00	3637700.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Jorgjie P. Beçka, Hafize B.Musabelliu	1/14- N.9	38.74	0.00	41.50	38.74	9460	366480.40	41.50	41.50	66140	2744810.00	3111290.40	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Arian Curri, Doloresha Perona	1/14- N.8	0.00	0.00	90.50	0.00	9460	0.00	90.50	90.50	66140	5985670.00	5985670.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Nadire Berisha (Isufaj)	1/14- N.6	73.26	0.00	73.26	73.26	9460	693039.60	73.26	73.26	66140	4845416.40	5538456.00	Barrë hipot. Union Bank
8	Nadire Berisha (Isufaj)	1/14- N.5	0.00	0.00	9.00	0.00	9460	0.00	9.00	9.00	66140	595260.00	595260.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Iliran I.Duka, Jonida D.Duka	1/237	24.10	0.00	24.10	24.10	9460	227986.00	24.10	24.10	66140	1593974.00	1821960.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Bukurije Sali Hoxha	1/234	24.10	0.00	24.10	24.10	9460	227986.00	24.10	24.10	66140	1593974.00	1821960.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Musa Xhepa e tjere	1/192	32.00	0.00	0.00	32.00	9460	302720.00	0.00	0.00	66140	0.00	302720.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Burbuqe Elezi (Qafmoll)etj	1/311	54.00	0.00	0.00	54.00	9460	510840.00	0.00	0.00	66140	0.00	510840.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Bardhul Stavri	lluster	0.00	0.00	0.00	0.00	9460	0.00	0.00	0.00	66140	0.00	0.00	Nuk konfirmohet
14	Kujtim Shengjergji		0.00	0.00	0.00	0.00	9460	0.00	0.00	0.00	66140	0.00	0.00	Nuk konfirmohet
	TOTALI					270.59	2559781.40			410.77	27168327.80		29728109.20	

**2. LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE E PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS LIDHËSE MIDIS
RRUGËVE “QEMAL STAFI” DHE “ESAT BORDI”**

			Vërtetim pronësie			Truall			Njësi				Shpronësimi	
N r.	Familja	Nr.	m ²			shpronësi m	çmimi	shpronësim	Sip. e njësisë m ²		çmimi	shpronësim	SHUMA	Lloji i dokumentit
	që shpronësohet	Pasur	truall	banese	njesi	m2	lek/m2	leke	preket	shprons	leke/m2	leke	leke	
1	Allbert Minella Buzo	8/77	545.00	214.00	0.00	32.75	7502	245690.50	0.00	0.00	68098	0.00	245690.50	Hipotekë në favor Alpha Bank
2	Merita Mehmet Qorri	8/253	263.16	67.10	0.00	256.35	7502	1923137.70	0.00	0.00	68098	0.00	4918993.50	Konfirmohet nga ZVRPP-ja
3	Merita Mehmet Qorri	8/344	100.11	0.00	0.00	79.74	7502	598209.48	0.00	0.00	68098	0.00	598209.48	Konfirmohet nga ZVRPP-ja
	TOTALI					368.84		2767037.68				0.00	5762893.48	